



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

LIGJ

Nr. 37/2015

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA KËSHILLI I MINISTRAVE
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, DHE KOMISIONIT EUROPIAN PËR
RREGULLAT E ZBATIMIT TË MBËSHTETJES FINANCIARE TË BE-SË PËR
SHQIPËRINË, NË KUADËR TË INSTRUMENTIT PËR ASISTENCËN
E PARANËTARËSIMIT (IPA II)**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Europian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II), sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ilir META

Miratuar në datën 9.4.2015